

PERSPECTIVE AND MANAGEMENT OF TOURIST ENVIRONMENT IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

Baki Koleci

University “Haxhi Zeka” Peja Kosovo, baki.koleci@hotmail.com

Redon Koleci

National Military University, Veliko Tarnovo, Bulgaria, redon_koleci@hotmail.com

Abstract: Tourism in developed countries, but also in some transition countries, is an important export product and a generator of employment. It includes a wide array of phenomena and relationships that arise during the touristic journey, while in its realization it comes to the economic, but also the ecological, social and cultural aspect of life. Tourism in Kosovo is an important economic branch. The Tourism Industry of Kosovo has realized 10-12% of the domestic social product, depending on the year in question and whether all the direct factors (hotel industry, gastronomy) or indirect factors (agriculture, construction, etc.) have been taken into account.

The large turnout of the tourism economy in the local social product reveals, in the first place, the weaknesses of other sectors of the economy, while the tourism potential has not been utilized as well.

Intensive development is largely spontaneous and uncontrolled in post-war hotels, accompanied by imbalance in the environment and territory. These consequences are detrimental to the interests of the two groups: local residents and respective tour operators.

Quality planning of space is one of the most important preconditions for the long-term and sustainable development of tourism in Kosovo.

It is appreciated that after defining the status of Kosovo, the interest of investors to invest in the tourism sector is greater, but also in other sectors of the economy that directly or indirectly influence the development of the tourism sector so that the government most works for the development of tourism in different regions of Kosovo, is now in the final stage the international tender for the privatization of Brezovica, where according to the information there are a number of interested persons appearing in the tender for privatization of the tourist complex of Brezovica.

Today's modern tourism does not ask where we are going but what we will do where we are going. Kosovo institutions are seriously involved in managing tourism firstly to build conditions to attract foreign tourists and to convince citizens themselves that there are conditions in their country, the money they spend in other countries can help the economy of Kosovo.

However, the conditions and nature that nature has created in Kosovo requires a more serious approach to elevating it to a higher level given the conditions to be met to keep up the turrent. Tourism is an industry characterized by intensive labor involvement. Human resources for this industry have been rated as "raw materials" or are anticipated by experts as the most important factor to be faced by this industry over the last decades and onwards the Kosovo government has set up a university education school for tourism which can be said that there are many well-prepared frames. Starting from this apparent tourism site, infrastructure and building up of incomparable units is progressing day by day. It is time to evaluate the motivation of visitors who pay for a couple of days of summer or winter in one place.

Keywords: Tourism Management, Intensive Development, Tourism Economy, Industry, Tourism, Product, Offers Other Requirements.

PERSPEKTIVA DHE MENAXHIMI I MJEDISIT TURISTIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Baki Koleci

Universiteti “Haxhi Zeka” Pejë Kosovë, baki.koleci@hotmail.com

Redon Koleci

National Military University, Veliko Tarnovo, Bulgaria, redon_koleci@hotmail.com

Abstrakt: Turizmi në vendet e zhvilluara, por edhe në disa shtete në tranzicion, është produkt i rëndësishëm eksporti dhe gjenerator i punësimit. Përfshinë një gërshetim të gjerë dukurish dhe raportesh që lindin gjatë kohës së udhëtimit turistik, ndërsa në realizimin e tij vjen në shprehje aspekti ekonomik, por edhe ekologjik, social dhe kulturor i jetës.

Në Kosovë turizmi është degë e rëndësishme ekonomike. Industria Turistike e Kosovës ka realizuar 10-12 % të produktit shoqëror vendor, varësisht nga fakti për cilin vit është fjala dhe a janë marrë parasysh të gjithë faktorët e drejtpërdrejtë (industria hoteliria, gastronomia) ose faktorët indirekt (bujqësia, ndërtimtaria, etj.)

Pjesëmarrja e madhe e ekonomisë turistike në produktin shoqëror vendor zbulon, në radhë të parë, dobësitë e sektorëve tjerë të ekonomisë ndërsa potenciali turistik as që është është shfrytëzuar sa duhet.

Zhvillimi intensiv, në masë të madhe është spontan dhe i pakontrolluar në hotelerinë e pasluftë s, ku shoqërohet me pasoja disekuilibruese për mjedisin dhe territorin. Këto pasoja janë të dëmshme për interesat e dy grupeve: banorë vendas dhe operatorët turistik përkatës.

Planifikimi cilësor i hapësirës është një ndër parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të turizmit në Kosovë.

Vlërohet se pas definimit të statusit të Kosovës interesimi i investitorëve për të investuar në sektorin e turizmit është më i madh por edhe në sektorët tjerë të ekonomisë të cilët në mënyrë direkte apo indirekte ndikojnë në zhvillimin e sektorit të turizmit kështu që qeveria me të madhe po punon për zhvillimin e turizmit nëpër rajone të ndryshme të Kosovës, tani është në fazën e fundit tenderi ndërkombëtar për privatizimin e Brezovicës ku sipas informatave ka një numër të konsiderueshëm të interesuarish që paraqiten në tenderin për privatizim të kompleksit turistik të Brezovicës.

Turizmi i sotëm modern nuk bënë pyetjen se ku do shkojmë por çfarë do bëjmë atje ku do të shkojmë. Insitucionet e Kosovës merren serozisht me menaxhimin e turizmit pikë së pari për të ndërtuar kushte për të tërhequr turistët e huaj dhe për të bindur vetë qytetarët e vet se ka kushte edhe në vendin e tyre, parat që ata i shpenzojnë në vende tjera mund të ndihmojnë ekonominë e Kosovës.

Megjithatë kushtet dhe veçorit që ka krijuar natyra në Kosovë, kërkon një qasje më serioze për të ngritur atë në një nivel më të lartë duke pasur parasysh kushtet që duhet plotësuar për të mbajtur një tursit. Turizmi është një industri që karakterizohet nga përfshirja intensive e krahut të punës. Burimet njerëzore për këtë industri janë vlerësuar si “lëndë e parë” apo janë parashikuar nga ekspertët si faktori më i rëndësishëm që do të përballohet nga kjo industri gjatë dekadave të fundit dhe në vazhdim qeveria e Kosovës ka ngritur në nivelin universitar shkollimin për turizëm për të cilën mund të themi se ka kuadra shumë të pregaditura. Duke u nisur nga kjo faqja e dukshme e turizmit infrastruktura dhe ndërtimi i njësive akomoduese po përparon nga dita në ditë. Ka ardhur koha të vlerësohet motivimi i vizitorëve të cilët paguajnë për të kaluar disa ditë verë apo dimri në një vend.

Fjalët Kyçe: Menaxhimi i turizmit, Zhvillimi intenziv, Ekonomia turistike, Industria, Turizmi, Produkti, Oferta

Kërkesa e tjerë.

HYRJE

Menaxhimi i turizmit nënkuptohet si lëvizje e njerëzëve me qëllim rekreacioni, argëtimi, shërimi dhe zgjerimi të njohurive kulturore. Kosova është hapësirë e vogël gjeografike, me motivet natyrore dhe njerëzore që ka ofron mundësi të mira për zhvillimin e disa llojeve të turizmit vendës, rajonal, ndërkombëtar, stacionar dhe transit. Kosova ka vende turistike që mund të shfrytëzohen nga popullsia e vet për ekskursione, për sport, rekreacion, pushim, kulturë, për arsim e edukim. Mirëpo, ky lloj turizmi nuk ka qenë dhe ende ka mbetur i pazhvilluar sa duhet.

Deri në ditët e sotme në mungesë të rrugëve të mira, në Kosovë ka pak lëvizje turistike edhe pse Kosova ka pozitë të mirë gjeografike. Tani me ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit rrugor automobilistik dhe përmirsimin e gjendjes ekonomike, fillojnë lëvizjet turistike të shtohen.

Qarkullimet turistike lokale, individuale, familjare e grupe me qëllim pushimi e rekreacioni bëhen sidomos gjatë verës për t'u freskuar pranë bazeneve, lumenjëve, liqeneve, ose gjatë stinës së dimrit në qendrat e skijimit (Brezovicë e Rugovë) e gjetiu. Turizmi në Kosovë kryesisht është i orjentuar në turizmin:

- Turizmi Malor
- Turizmi shëndetësor
- Objekte Natyrore
- Objekte kulturore-historike

TURIZIMI MALOR NË KOSOVË

Malete e Sharrit pë katesisht Prevala, Brezovica. Bjeshkët e Nemuna (Rugova) Gjeravica është maja më e lartë me lartësi mbidetare 2656 m

Pra Kosova si tëresi ndahet në 5 rajone turistike, 1. Rajoni Turistik i Prishtinës, 2. Rajoni turistik i Malit Sharr, 3. Rajoni Turistik i Anamoravës. 4. Rajoni Turistik i Alpeve Shqipëtare dhe Rajoni turistik Qëndrorë i Kosovës ku njëkohësisht hynë në Rajonin turistik të Prishtinës.

TURIZMI SHËNDETËSOR NË KOSVOË

Kosova ka banjo rehabilituese dhe ka resurse natyrore të cilat janë dëshmuar të shërueshme sa i përket Ajrit dhe Ujërave që ka sidomos në Alpet shqiptare (gjegjesisht në bjeshkët e Deçanit). Efektiviteti i tyre është i shumëanshëm, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e bimëve dhe ajrit të pastër që e ofron lartësia e Alpeve me lartësi mbidetare prej 2656 metra-Maja e Gjeravicës-Deçan. Prandaj me investimin që po bëhet në infrastrukturë kjo do të jetë e mrekullshme dhe do të sjellë shërim 100% të atyre personave që vuajn nga sëmundjet e frymëmarrjes dhe shumë sëmundjeve të tjera të cilat drejtpërdrejt kanë ndikim në mushkërit e njeriut.

OBJEKTET NATYRORE NË KOSOVË

Shpella e Gadimes, Bifurkacioni në fshatin Nerodime (Ferizaj), Ujëvara e Mirushës, Burimi i Drinit të Bardhë.

OBJEKTET KULTURORE-HISTORIKE NË KOSOVË

Departamenti e Kulturës, në kuadër të Ministrisë së Kulturës, kryejnë veprimtarinë e tyre të rregullt 32 institucione të kulturës 10 prej të cilëve i takojnë nivelit qendrorë dhe 22 i takojnë nivelit ndër komunal/rajonat. Pjesë të trashëgimisë kulturore dhe artistike të Kosovës disa prej të cilave paraqesin mijëvjeçarin kulturorë, historik e civilizues janë:

MUZETË

- Muzeu Etnografik në Pejë
- Muzeu Kombëtar i Kosovës
- Muzeu Hekurudhorë i Kosovës
- Muzeu Etnologjik “Emin Gjiku” në Prishtinë
- Lidhja shqipëtare e Prizrenit
- Muzeu Arkeologjik në Prizren
- Muzeu në Mitrovicë
- Hamamet dhe Kalatë e shumta të shndërruara në Muze.

Kosova edhe pse nuk ka det, ka mjaftë resurse turistike që krijojnë mundësin për zhvillimin e llojeve të tjera të turizmit, trashëgiminë kulturore dhe natyror që i krijojnë mundësi për të investuar dhe për krijimin e një produkti turistik atraktiv për turistët. Vështruar nga aspekti i turizmit, Kosova është e përbërë prej pesë rajoneve turistike: Rajoni turistik i Alpeve Shqipëtare, Maleve të Sharrit, Rajoni turistik i Prishtinës, Rajoni turistik i Mitrovicës (Shalës së Bajgorës), Rajoni turistik i Anamoravës. Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare dhe rajoni turistik i Maleve të Sharrit, janë rajone që dallohen jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon me mundësitë që ekzistojnë për zhvillimin e turizmit malor e sidomos të atij dimroro-sportiv. Studimet e deritanishme të bëra nga institucione vendore dhe ndërkombëtare tregojnë se vetëm në këto dy rajone turistike ekzistojnë kushte për ngritjen e më se 20 qendrave turistike sipas standardeve ndërkombëtare për zhvillimin e turizmit dimëroro sportiv. Edhe tri rajonet tjera turistike kanë specifikat e veta që janë atraktive për zhvillimin e llojeve të caktuara të turizmit. Kosova është e pasur edhe e njohur edhe me atraksione tjera turistike siç janë: Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Ujëvara e Mirushës, numër i konsiderueshëm i burimeve termale, (Banja e Pejës, Klokotit, e Mitrovicës etj), një mori shpellash ndër to duhet veçuar Shpellën e Gadimës, Bifurkacioni i lumit të Nerodimës.

Buxheti i Kosovës mbështet finaciarisht turizmin komfor mundësive aktuale që ka, për krijimin e një klime të përshtatshme për zhvillimin e turizmit. Mbështetje financiare dhe teknike deri me tani ka përfutur nga ministria e tregëtisë dhe turizmit edhe nga donatorët e jashtëm siç janë: GTZ, AER, UNDP.. Departamenti i Turizmit në kuadër të programit të vetë të punës, një prej aktiviteteve të veta e ka edhe krijimin marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet fqinje dhe më gjërë, krijimin e kushteve të volitshme për një bashkëpunim të ndërsjellë të komunitetit të biznesit turistik kosovar me komunitetin e bizneseve turistike të Ballkanit dhe më gjërë.

Vlërohet se pas definimit të statusit të Kosovës interesimi i investitorëve për të investuar në sektorin e turizmit është më i madh por edhe në sektorët tjerë të ekonomisë të cilët në mënyrë direkte apo indirekte ndikojnë në zhvillimin e sektorit të turizmit kështu që qeveria me të madhe po punon për zhvillimin e turizmit nëpër rajone të ndryshme të Kosovës, tani është në fazën e fundit tenderi ndërkombëtar për privatizimin e Brezovicës ku sipas informatave ka një numër të konsiderueshëm të interesuarish që paraqiten në tenderin për privatizim të kompleksit turistik të Brezovicës.

Turizmi i sotëm modern nuk bënë pyetjen se ku do shkojmë por çfarë do bëjmë atje ku do të shkojmë. Insitucionet e Kosovës merren seriozisht me menaxhimin e turizmit pikë së pari për të ndërtuar kushte për të tërhequr turistët e

huaj dhe për të bindur vetë qytetarët e vet se ka kushte edhe në vendin e tyre, parat që ata i shpenzojnë në vende tjera mund të ndihmojnë ekonominë e Kosovës.

Megjithatë kushtet dhe veçorit që ka krijuar natyra në Kosovë, kërkon një qasje më serioze për të ngritur atë në një nivel më të lartë duke pasur parasysh kushtet që duhet plotësuar për të mbajtur një tursit. Turizmi është një industri që karakterizohet nga përfshirja intensive e krahut të punës. Burimet njerëzore për këtë industri janë vlerësuar si “lëndë e parë” apo janë parashikuar nga ekspertët si faktori më i rëndësishëm që do të përballohet nga kjo industri gjatë dekadave të fundit dhe në vazhdim qeveria e Kosovës ka ngritur në nivelin universitar shkollimin për turizëm për të cilën mund të themi se ka kuadra shumë të pregaditura. Duke u nisur nga kjo faqja e dukshme e turizmit infrastruktura dhe ndërtimi i njësive akomoduese po përparon nga dita në ditë. Ka ardhur koha të vlerësohet motivimi i vizitorëve të cilët paguajnë për të kaluar disa ditë verë apo dimri në një vend.

Zyrtarët e Departamentit të turizmit thonë se përmes mediave elektronike dhe të shkruara po promovojnë rajonet turistike, punohet që shumë shpejt të promovohen spote publicitare sensibilizuese që i tregojnë opinionit publik vendas rëndësinë që ka turizmi ynë në zhvillimin ekonomik, të nxisin sjelljen e kulturuar dhe shërbimin në nivelin e duhur.

Diaspora shqiptare bënë një nga flukset më të mëdha të turizmit në Kosovë duke ardhur që ti kalojnë pushimet e tyre në atdhe dhe në këtë mënyrë sezoni veror ka një qarkullim të madh në të gjitha aspektet. Vendet të cilat më së shumti i vizitojnë mërgimtarët tanë janë qytetet për rreth ku jetojnë pasi shumica e tyre dëshirojnë që të jenë më pranë familjeve ndërsa rinia si zakonisht frekuoneton shumë baret dhe kafenetë kosovare ku pothuajse gjatë gjithë sezonit janë të stërmëbushura. Një frekuentim tjetër i të rinjve janë edhe pishinat private të cilat gjithashtu janë të stërmëbushura gjatë gjithë sezonit veror. Këtu duhet theksuar se qytetarët tanë me punë të përkoshme jashtë vendit si mikpritja sjellin në Kosovë miq dhe shoqëri jo shqiptarë të cilët mahniten me bukuritë dhe mikpritjen e Kosovës dhe ata pastaj vin me familjet e tyre si turist në fshatrat tona malore dhe fushore nëpër hotele dhe bujtina të cilat me të madhe po ndërtohen në Bjeshkët e Rugovës, Deçanit, Prevallës dhe Brezovicës, gjithëkund në Kosovë. Përveç sezonit veror, me përfundimin e shkollave gjatë fundit të pranverës, fluksi i nxënësve në formë grupore të quajtura "ekskurzione" vizitojnë vendet më turistike të Kosovës pothuajse në të gjitha anët duke bërë një shëtitje një ditore rreth Kosovës. Pikat më të vizituara gjatë këtyre ekskurzioeve janë: Prizreni, Ujvara e Mirushës, Burimi i Drinit të Bardhë, Gryka e Rugovës, Prekazi legjendar, Prishtina, Shpella e Gadimës si dhe disa pjesë tjera duke mos harruar Istogun dhe restorantin „Trofta” mrekulli e kohë së pastaj pjesën më të ulët të Kosovës Vermicën, e cila përveç bukurive natyrore me male, lumin Drin dhe dy burime të ujërave sjell ndër specialitetet më të mira nga peshku. Departamenti i turizmit i cili merret zyrtarisht me çështjen e turizmit në Kosovë ka shpallur disa zona turistike në tërë Kosovën duke përfshirë:

- Brezovica
- Malet e Sharrit
- Gryka e Rugovës
- Shpella e Gadimës
- Ujvara e Mirushës
- Burimi i Drinit të Bardhë
- Prevala
- Monumentet kulturore etj.

VENDET MË TË PREFERUARA PËR TURISTËT E HUAJ POR EDHE ATA VENDOR NË KOSOVË:

1. Malet e Sharrit

Shtrihen në Jug-Lindje të Kosovës duke filluar nga afërsia e Prizrenit dhe shkon pjerrtas me majet apo thepave në formë piramidale të radhitura njëra pas tjetrës apo siç e quante që nga antikiteti populli ilir, majat e sharrës, nga ngjajshmëria në thepat e sharrës, që formojnë figura të njëpasnjëshme karakteristike në zemër të Ballkanit. Bjeshkët e Sharrit janë të njohura qysh nga antikiteti në dokumente të autorve të ndryshëm, që nga shekulli i V p.e.s. më emrin Mont Skardus, nga Herodoti, i cili i përshkruan edhe fiset ilire dhe kufizimet e tyre. Malet e Sharrit u quajtën Çar-dagh, në dokumentet otomane dhe europiane. Maja më e lartë nga fillojnë këto vargmale, mendohet se emrin e ka me origjinën frenge, "*Pamje e bukur*" "*le bo ten*" e që mbeti pastaj në popull si Maja e Lubotinit e cila kulminon 2553 m mbi nivelin e detit. Shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë janë tepër të lidhur shpirtërisht me këto male dhe i konsideron si të shenjta. Në muajn Qershorë, për çdo vitë mbahet një procesion në drejtim të Lubotinit, duke hecur këmbë deri lartë, ku marrin pjesë me mija këmbësorë në shenjë respekti ndaj kësaj bukurie natyrore që njerzit janë të vetëdijshëm në mbrojtjen e ambijentit dhe pylltarisë, florës dhe faunës që është shumë e

pasur në këto bjeshkë. Mu në maje të malit të *Pamjes së Bukur* apo *Lebotenit*, rrjedh një burim i madh uji që vendasit e këtyre anve e quajnë *Pusi i Nikës*.

2. Brezovica është qendër Kosovare e turizmit dimëror dhe veror në Malet e Sharrit. Shtigjet e skijimit gjenden 12 km larg fshatit me të njëjtin emër në komunën e Shtërpçës. Me mundësitë që Brezovica ofron për dashamirët e skijimit, ajo është qendra turistike më e vizituar gjatë dimrit në Kosovë. Hapësira e qendrës së skijimit është rreth 2500 hektarë, në lartësinë mbidetare 1718-2522 m. Përbrenda kësaj hapësire janë shtigjet e skijimit me gjatësi mesatare rreth 4 km dhe me një lakueshmëri mesatare prej 38%. Në lartësinë mbidetare prej 1718 m, në Livadhin e Madh gjendet teleferiku më i ri. Stacioni i daljes nga ky teleferik është në lartësinë 2212 m mbi nivelin e detit. Qendra e skijimit "Brezovica" është e hapur për dashamirët e skijimit gjatë gjithë stinëve të vitit, sipërfaqja e mbuluar me borë zvogëlohet por prapë lë mundësinë e shfrytëzimit. Kjo qendër ka disa hotele që ofrojnë shërbime cilësore të kategorive më të larta. Ndër hotelet më të njohura është Hoteli Narcis i kategorisë së parë i cili gjendet në lartësinë mbidetare prej 900 m, dhe është 9 km larg shtigjeve të skijimit. Në lartësinë mbidetare 1700 m gjendet hoteli i kategorisë "B", Hoteli Molika, i cili gjendet pranë shtigjeve të skijimit. Në këtë hotel kryhen shërbimet që kanë të bëjnë me pajisjet për rrëshqitje.

3. Liqeni i Batllavës është një liqen i ndërtuar artificial në vitet e 70-ta. Ky liqen gjendet në fshatin Batllavë, komuna e Podujevës. Funkcioni i këtij liqeni është furnizimi me ujë të pijshëm i Prishtinës komune së Podujevës dhe retheve të tyre. Sot ky liqen shfrytëzohet edhe për pushime verore, freskim, peshkim, relaksim në restorane të ndryshëm si dhe me bukuritë natyrore etj.

4. Shpella e Gadimes gjendet në fshatin Gadime në afërsi të Lipjanit. Ajo është e gjatë 1500 metra. Mirëpo për turistët është i mundshëm shikimi i vetëm 800 metrave të para të shpellës, pasi që për pjesën tjetër të shpellës ende nuk janë të mundshme kalimet. Gjatë verës temperatura në brendi të shpellës është 8-11 gradë celsius dhe gjatë dimrit 11-13 gradë Këtu i hasim Stalagmitet dhe Stalagtitet.

5. Shpella e Azem Galices hyrja mjaftë e ngushtë në shpelle. Kjo shpellë gjendet në afërsi të magjistrales Peje-Prishtinë, rreth 30 km nga Peja, dhe në afërsi të fshatit Gllarevë. Nuk është e hulumtuar deri më sot por është e njohur për atë se këtu kanë qenë të fshehur eshtrat e trimit dhe luftëtarit tonë të njohur për liri Azem-Bejtë-Galicës, të cilat më pastaj u rivarosen në fshatin e tij, për atë edhe ka marrë këtë emër.

6. Gryka e madhe Në kufirin e Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë, gjenden vargmalet e mëdha të "Bjeshkëve të Nemuna" me një hapësirë prej rreth 3500 km². Për nga përmbajtja gjeologjike ato janë pjesë e vargmaleve Dinaride dhe këto nuk janë vargmale të pandërprera por më përpara një strukturë e rafshenaltave të mëdha si Brada, Maja e Rosit, Gjeravica, Guri i Kuq, Marashi, e shumë të tjera, me një lartësi mesatare gjer në 2000 m. Maja më e lartë e këtyre bjeshkëve të ashpra, të nderhyra nga lugina të thepisura në Shqipëri është Maja Jezercit 2694 m, dhe në pjesën Kosovare të këtyre vargmaleve është Gjeravica, me 2656 m lartësi mbidetare. Këto rrafshnalta janë të pasura më barë në pjesën e sipërme, dhe disa grupe të majave vazhdojnë mbi të, me një ambient tipik alpin. Direkt mbi qytetin e këndshëm Kosovar të Pejës, i cili shtrihet në një lartësi mbidetare prej 525 m dhe i cili për nga pozita e bukur që ka pranë bjeshkëve të larta, dhe aty ka hyrjen një gryke e veçantë dhe unike. "Lumi i Bardhë" i cili buron nga malet e larta gjatë shekujve ka formuar grykën në një gjatësi prej 25 km, përderisa lugina është një ndër më të egrat dhe një ndër më fasciuëset në Ballkan e cila njihet me emrin "Gryka e Rugovës", dhe ka një karakter të një kanjoni të madhë, me shkëmbinjë të lartë gjer në 800 metra, pothuajse krejtësisht vertikale. Përafërsisht në mesin e kësaj gryke, aty ku lumi e prenë një shkëmb të madhë gëlqeror, aty fillon të ngjitet edhe rrafshnalta e Lumbardhit me një madhësi prej 70 km² dhe mu prej aty zhvillohet një arterie signifikante dhe autoktone hidrologjike, në një formë të burimit të ngritur ujqor, i cili në fakt është edhe fillimi apo hyrja në këtë sistem të veçantë të shpellave dhe i cili quhet me emrin "Gryka e Madhe".

LITERATURA

Budinoski, M., (2011) Turizmologjia Shkup

Milladinovski, S., (2012) Ekonomika na Turizmot Shkup

Muhaxheri, N., Mundësitë dhe konceptet për zhvillimin e turizmit në regjionin e Pejës

Panov, N., (2012) Osnovi na Turizam Shkup